



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

Kom.Dh.Shk.II.nr.1431/22

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË-Dhoma e Shkallës së Dytë, me gjyqtarin Krenar Berisha, në çështjen përmbartimore të kreditorit Njësia për Intelegjencë Financiare-Ministria e Financave, Republika e Kosovës me seli në Prishtinë, ndaj debitoritme adresë Magjistrala Prishtinë-Qagllavicë, p.n, duke vendosur lidhur me ankesën e debitorit, të ushtruar kundër aktvendimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.231/21 të datës 25.02.2022, jashtë seancës me datë 12.09.2022, mori këtë:

A K T V E N D I M

REFUZOHET e pathemeltë ankesa e debitorit, me adresë Magjistrala Prishtinë-Qagllavicë, ndërsa Aktvendimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë - Departamenti i Përgjithshëm PPP.nr.231/21, të datës 25.02.2022, VËRTETOHET.

A r s y e t i m

Gjykata Themelore në Prishtinë-Departamenti i Përgjithshëm, me Aktvendimin e atakuar PPP.nr.231/21, të datës 25.02.2022, e ka refuzuar në tërësi si të pabazuar prapësimin e debitorit me seli në Magjistrallën Prishtinë-Qagllavicë p.n., të ushtruar kundër urdhrit për përmbartim P.nr.1275/20 të datës 29.12.2020, te lejuar nga përmbartuesi privat Destan Bujupaj në Prishtinë.

Kundër këtij aktvendimi në afatin ligjor ka ushtruar ankesë debitori, për shkak të shkeljes esenciale të dispozitave të procedurës administrative dhe të ligjeve të veçanta, vërtetimit të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike dhe zbatimit të gabuar të drejtës materiale, me propozim që Gjykata e shkallës së dytë, ta aprovoj si të bazuar ankesën e debitorit, të anulohet aktvendimi i gjykatës së shkallës së parë, dhe të shfuqizohet urdhëri për caktimin e përmbartimit të propozuar P.nr.1275/20 dt.29.12.2020. Në vendimin e atakuar konsiderojmë se është cënuar siguria juridike e palës paditëse. E paditura duke vepruar prej pozitive monopoliste në kohën e pandemis organizon duke thirrë seminare në kohën e pandemis globale, dhe për të njëjtat ndëshkoi paditësin.

Në shkresat e lëndës nuk ka përgjigje në ankesë

Dhoma e Shkallës e Dytë, i shqyrtoi shkresat e lëndës, aktvendimin e atakuar dhe pretendimet ankimore, në kuptim të nenit 3, paragrafi 2, të Ligjit nr.04/L-139 për Procedurën Përmbartimore si dhe në kuptim të nenit 194 dhe 208 të LPK-së, gjeti se:

-Ankesa e debitorit është e pabazuar.

Nga shkresat e lëndës rrjedh se kreditori, ka paraqitur propozim për përmbartim ndaj debitorit, në bazë të dokumentit të besueshëm-vendimin FIUAD..... të datës 27.08.2020. Përmbartuesi privat Destan Bujupaj nga Prishtina sipas propozimit të kreditorit, me urdhrin përmbartimor P.nr. 1275/20 të datës 29.12.2020, ka lejuar përmbartimin, me të cilën detyrohet debitori që kreditorit në emër të borxhit t'i paguaj shumën prej 50,000.00 euro, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore dhe shpenzimet e tjera të krijuara në pajtim me UA-MD-së.

Kundër urdhrin përmbartimor debitori ka ushtruar prapësim me datën 27.01.2021, ndërsa gjykata e shkallës së parë pas vlerësimit të prapësimin, me aktvendimin e ankimuar PPP.nr.231/21 të datës 25.02.2022, ka vendosë që ta refuzoj prapësimin e debitorit të paraqitur kundër urdhrin përmbartimor P.nr.1275/20 të datës 29.12.2020.

Në arsyetim të aktvendimit Gjykata e shkallës së parë ka vlerësuar vendimin FIUAD të datës 28.07.2020 i cili është i formës së prerë nga data 22.10.2020 dhe i cili është i ekzekutueshëm nga data 09.11.2020, në bazë të cilit organi përmbartues ka zbatuar përmbartimin, është dokument përmbartues në kuptim të neneve 21 dhe 22 të LPP-së dhe përbën bazë juridike për caktimin e përmbartimit ngase i ka plotësuar kushtet ligjore nga neni 24 dhe 27 i LPP-së për të qenë i përmbartueshëm dhe njëkohësisht i përshtatshëm për përmbartim. Po ashtu gjykata e shkallës i vlerëson si të pabazuar edhe pretendimet e debitorit si të paqëndrueshme dhe të pabazuara në ligj, për arsye se debitori nuk ka ofruar prova në mbështetje të pretendimeve të tij siç parashihet në nenin 69 par.4 të LPP-së dhe se nuk janë përmbushur kushtet ligjore për anulimin e Urdhrit të Përmbartuesit Privat të përcaktuara me dispozitat e nenit 71 të LPP-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë e Gjykates Komerciale, nisur nga kjo gjendje vlerëson se qëndrimi dhe përfundimi juridik i gjykatës së shkallës së parë është i drejtë dhe i ligjshëm pasi aktvendimi i ankimuar nuk është i përfshirë në shkelje thelbësore të dispozitave procedurale nga neni 182 par.2 pikat., b), g), j), k) dhe m) të LPK dhe nuk ka zbatim të gabuar dhe jo të potë të gjendjes faktike ndërsa ka zbatuar drejt dispozitat materiale për çka edhe Doma e Shkallës së Dytë kujdeset sipas detyrës zyrtare në kuptim të nenit 194 të LPK-së.

Dhoma e Shkallës së Dytë ka konstatuar se vendimi i shkallës së parë është bazuar në dokument të besueshëm, të paraparë me nenin 29 të Ligjit për Procedurën Përmbartimore nr.04/L-139, ku përcakton se *“përmbartimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet në bazë të dokumentit të besueshëm, me tutje ky nen parasheh se “dokumenti i besueshëm, është i*

përshatshëm për përmbardim po që se në të është treguar kreditori dhe debitori si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbardjes së detyrimit monetar”, e që në rastin konkret dokument i besueshëm është vendimi FIUAD të datës 28.07.2020 për shumën e detyrimit prej 50,000.00 euro. Andaj pretendimet ankimore të debitorit sa i përket shkeljeve esenciale të dispozitave të procedurës administrative, se aktvendimi i ankimuar ka të meta dhe mangësi juridike, nuk qëndron, dhe se edhe kjo gjykatë vlerëson qëndrimin juridik të gjykatës së shkallës së parë sepse e njëjta në bazë të dokumentacionit dhe shkresave në lëndë drejtë ka arsyetuar dhe vlerësuar gjendjen faktike dhe ka zbatuar drejt të drejtën materiale. Në këtë drejtim Dhoma e Shkallës së Dytë, vlerëson se aktvendimi i atakuar është i rregullt dhe i ligjshëm, kështu që mund të hetohet dhe vlerësohet ligjshmëria e tij, shkelje të cilat gjykata e shkallës së dytë i heton sipas detyrës zyrtare në bazë të nenit 194 të LPK-së. Në këtë drejtim pretendimet ankimore të debitorit u refuzuan si të pabazuara ndërsa aktvendimi i atakuar vërtetohet.

Në procedurën përmbardimore bëhet realizimi direkt i mbrojtjes juridike të konstatuar në dokumentin përmbardimor i cili përmban aktin juridik me të cilin vërtetohet ekzistimi i kërkesës dhe se nga ky dokument rrjedh e drejta e organit përmbardues që sipas propozimit të kreditorit të caktoj dhe zbatoj përmbardimin. Nëse pala debitore për çfarëdo rrethane apo arsye pretendon se pala kreditore kërkon përmbardimin e detyrimit pa bazë ligjore, si shkak i të cilave palës debitore eventualisht ka mundur të shkaktohet apo mund të shkaktohet çfarëdo lloji dëmi më rastin e kryerjes së përmbardimit sipas kësaj lënde, nuk ka pengesa ligjore që lidhur më këtë të drejtë e tij ta realizoj në kontest të rregullt pranë gjykatës kompetente, ngase një pretendim i tillë, nuk paraqet bazë ligjore për ndaljen, pezullimin apo përfundimin e përmbardimit në këtë rast.

Kompetenca e Gjykatës Komerciale –Dhoma e Shkallës së Dytë në Prishtinë për të vendosur nga ana e gjyqtarit individual në shkallë të dytë bazohet në dispozitën e nenit 3 par.2 të LPP me të cilën është paraparë se në shkallën e dytë vendimet i nxjerr gjyqtari individual.

Nga sa u tha më lartë në kuptim të nenit 209, par.1, pika b), të LPK-së e lidhur me nenin 17 të LPP u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

GJYKATA KOMERCIALE NË PRISHTINË
Dhoma e Shkallës së Dytë
Kom.Dh.Shk.II.nr.1431/22 me datë 12.09.2022

Gjyqtari
Krenar Berisha